



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 545/3 Prot.

Tiranë, më 30/06/2016

VENDIM

Nr. 39, datë 30/6/2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe neneve 80-104 të Kodit të Procedurave Administrative,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Birn Albania", ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 545 Prot., datë 10.05.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Shërbimit Informativ Shtetëror me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare".

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën nr. 299 Prot., të datës 18.03.2016 ka kërkuar nga Shërbimit Informativ Shtetëror t'i vihet në dispozicion:

1. Analiza vjetore të SIGURIMIT për vitet 1980-1989
2. Shifra e personave të ndjekur lidhur me figura të ndryshme armiqësore gjatë periudhës 1980-1989, referuar dosjeve të kategorisë 2A.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri me urdhrin Nr.142, datë 20.05.2016 urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/Shërbimit Informativ të Shtetit. Gjatë inspektimit, koordinatori i të drejtës për informim sqaroi se me shkresën nr.210/1 Prot., datë 31.03.2016 i ka kthyer përgjigje Qendrës "Birn Albania" duke sqaruar se informacioni i kërkuar nuk mund t'i vihet në dispozicion pasi ky informacion është vetëm në ruajtje dhe jo për veprime të tjera përfshirë dhe ekspozimin për të tretët.

Qendra "Birn Albania" në ankesën me nr.545 Prot, datë 10.05.2016 parashtron se: "Refuzimi për dhënie të informacionit nuk është i bazuar në ligj dhe mosdhënia e informacionit nuk mund të justifikohet në bazë të nenit 16 të ligjit 8043 "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik" për arsyet e mëposhtme:

1. Ligji 8043 "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", është specifik dhe nuk flet për sistemin e ruajtjes apo klasifikimit të informacionit të "Sigurimit" në përgjithësi por vetëm për mënyrën e trajtimit të atij informacioni që ka lidhje me personat, kontrolli i figurës së të cilit është kryer në bazë të ligjit.
2. Informacioni i kërkuar nga BIRN është jopersonal dhe nuk prek personat subjekt i ligjit 8043 dhe as persona të tjerë që mund të kenë qenë të punësuar, hashkëpunëtorë apo subjekte të punës së Sigurimit.

3. Informacioni i kërkuar është në thelb raport statistikor, në të nuk besohet se gjenden të dhëna të karakterit personal dhe për rrjedhojë nuk ka arsye që të mos jepet.
4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka krijuar një precedent në çështjen *Respublica vs. Shërbimi Informativ i Shtetit* në vendimin nr. 7 datë 23.01.2015, ku ka sanksionuar se informacionet me karakter raportues/ statistikor nuk mund të jenë sekret as për ngjarje të kohës sonë. Për rrjedhojë informacioni i llojit raportues/ statistikor i Sigurimit, nuk mund të jetë sekret.

Në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seancë dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Me shkresën nr. 545/3 Prot., datë 02.06.2016, Zyra e Komisionerit njoftoi palët në një seancë dëgjimore në datën 10.06.2016, ora 10:00 pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Në seancën dëgjimore u paraqit ankuesi, Qendra "BIRN Albania" dhe përfaqësues të Shërbimit Informativ të Shtetit. Palët e sipërcituara pasi paraqitën pretendimet e tyre me gojë, depozituan parashtrimet edhe në formë shkresore.

Autoriteti Publik/Shërbimi Informativ i Shtetit parashtrori se:

1. Së pari, Shërbimi Informativ i Shtetit, përjashtohet nga detyrimi që kërkon publikimin e informacionit të klasifikuar bazuar në ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998 "Për Shërbimin Informativ Kombëtar", i ndryshuar, neni 10 i tij, përcakton se:

"Shërbimi Informativ Kombëtar përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të informacionit, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të personelit.

2. Së dyti, neni 16 i ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995 "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", parashikon se:

"Në mungesë të dispozitave të tjera ligjore ndalohet marrja kontakt me dokumentacionin objekt i këtij ligji për vendime që lidhen me personat pas vitit 2001 e deri në vitin 2025. Për ruajtjen e arkivit ngarkohen Shërbimi Informativ Kombëtar, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit."

Këto institucione janë ngarkuar nga ligji vetëm për ruajtjen e dokumenteve të ish-Sigurimit dhe jo për të kryer veprime të tjera, përfshirë edhe ekspozimin për të tretët.

Ligji nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar, neni 20 përcakton se, me ruajtje të informacionit të klasifikuar nënkuptojmë tërësinë e masave dhe kontrolleve për mbrojtjen e tij.

3. Lidhur me konceptin ligjor të deklasifikimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", ligji nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar, përcakton kritere lidhur me këtë proces.

Ligji nr. 8457, datë 11.2.1999, parashikon se, informacioni që përbën sekret shtetëror klasifikohet nga një autoritet i klasifikimit origjinal dhe në rastin konkret autoriteti i klasifikimit origjinal është ish-Sigurimi i Shtetit.

Në bazë të nenit 13 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999, me deklasifikim nënkuptohet ndryshimi i autorizuar i statusit të informacionit, nga informacion i klasifikuar, në informacion i paklasifikuar. Gjithashtu, ky nen përcakton se, autoritet deklasifikimi është autoriteti i klasifikimit origjinal.

Ndërsa neni 22 i ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, parashikon se, një institucion nuk ka të

drejtë të zbulojë informacionin origjinal të klasifikuar nga një institucion tjetër pa një autorizim nga institucioni apo një akt ligjor për këtë qëllim.

SHISH rezervon vetëm të drejtën e ruajtjes së materialeve dhe jo të deklasifikimit apo ekspozimit të tyre.

4. Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", është parashikuar ngritja e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, i cili është organi kompetent lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Shërbimi Informativ Kombëtar, sot Shërbimi Informativ i Shtetit, është krijuar me ligj për herë të parë në vitin 1991 dhe legjislacioni aktual nuk i njeh të drejtën atij që të publikojë para publikut dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit.

Dokumentacioni i krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit do të trajtohet në përputhje me ligjin nr. 45/2015 nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit Përfundimisht parashtron se, ankimimi dhe kërkesa e Qendrës "BIRN Albania" nuk është në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues.

Komisioneri pas shqyrtimit të ankesës, parashtrimeve, seancës dëgjimore, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës, konstatoi se informacioni i kërkuar është informacion publik. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, "informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Informacioni i sipërcituar nuk është vënë në dispozicion të kërkuarit pasi është vetëm në ruajtje nga ky institucion, kjo bazuar në ligjin nr.45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", sipas së cilit organi kompetent për hapjen e këtyre dokumentave, është Autoriteti për Informimin, mbi dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit. Por, po në këtë ligj parashikohet se informacioni që do të trajtojë institucioni i ri do të ketë karakter personal dhe nuk bëhet fjalë për informacionin e kërkuar nga ankuesi.

Autoriteti Publik/ Shërbimit Informativ Shtetëror sqaron se bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror" i ndryshuar, ndalon publikimin e informacionit nga institucioni i cili nuk është i autorizuar për këtë qëllim Ky ligj ndalon publikimin por nuk ndalon rishikimin e klasifikimit. Mirëpo duke qenë se nuk është krijuar ende një institucion që do të trajtojë këto dokumenta, përfshirë edhe klasifikimin apo deklasifikimin, atëherë përgjegjës për këtë proces është Autoriteti pranë të cilit janë arkivuar këto dokumente, konkretisht SHISH. Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesit e SHISH pranuan se në rast nevojë këto dokumenta mund të konsultohen. Për gjithë sa më sipër vërtetohet se kemi të bëjmë me informacion publik që administrohet nga Autoriteti publik/ SHISH sipas përkufizimit të nenit 2 pika 2 e Ligjit.

Nga analiza e fakteve dhe pretendimeve të paraqitura gjatë seancës dëgjimore, nga ana e Autoritetit Publik/ Shërbimit Informativ Shtetëror, nuk rezulton i përmbushur detyrimi i sanksionuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", neni 17, pika 5 ku citohet se "E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara "sekret shtetëror". Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit...".

Autoritetit Publik/ Shërbimi Informativ Shtetëror duhet të kishte përmbushur detyrimin për të nisur menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit për informacionin e kërkuar duke njoftuar kërkuarin për ndjekjen e kësaj procedure.

Për informacionin mbi shifrat e personave të ndjekur lidhur me figura të ndryshme armiqësore gjatë periudhës 1980-1989, referuar dosjeve të kategorisë 2A, Komisioneri vlerëson se informacionet statistikore nuk mund të jenë sekret dhe si të tilla duhet të vendosen në dispozicion të kërkuarit.

Theksojmë se, e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës BIRN ndaj Autoritetit Publik/ Shërbimit Informativ i Shtetit, Komisioneri vlerëson se duhet vijuar me zbatimin e procedurës së parashikuar në nenin 17, pika 5 e Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 5 të nenit 17, nenin 24, nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

V E N D O S A:

1. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Shërbimit Informativ i Shtetit, për fillimin menjëherë të procedurës së rishikimit të klasifikimit të dokumentacionit të kërkuar dhe njoftimin e kërkuarit.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
3. Ky vendim u dha sot në datë 30. 6 .2016.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
